



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK. Nr. 146/2023

Datë: 6 prill 2023

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafi 1 dhe 1.14 i Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 12 të Ligjit për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 13 të Rregullores për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, në mbledhjen e 307-të, të mbajtur me datë 6 prill 2023, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e gjyqtarit Faton Ademi për përjashtim si kryesues i panelit hetimor në lëndën disiplinore Nr.AD/KGJK/04/2023/GJTHPR-AD/GJTHPR/02/23.
2. Për të shërbyer si Kryesues në këtë panel hetimor caktohet gjyqtari i Gjykatës Themelore në Gjakovë Drilon Haraçia

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me 28 mars 2023, ka pranuar nga gjyqtari Faton Ademi, kërkesën për përjashtim si Kryesues i panelit hetimor në lëndën disiplinore Nr.AD/KGJK/04/2023/GJTHPR-AD/GJTHPR.nr.02/23.

Kërkesën për përjashtim si Kryesues i panelit hetimor në lëndën e lartë cekur, gjyqtari Faton Ademi e ka mbështetur në arsyen se në këtë rast ankuesi është drejtoresh e organizatës Kosova, për të cilën në tri (3) vitet e fundit është angazhuar në cilësinë e trajnuesit dhe ekspertit për trajnime, moduli që i referohet dhunës në familje dhe dhunës ekonomike. Nga ky angazhim gjyqtari Ademi kishte përfituar mjete financiare si kompensim për këtë angazhim, andaj procedimi i mëtutjeshëm i kësaj lënde sipas vlerësimit të gjyqtarit Ademi mund të kuptohet si jo objektiv nga subjekti ankuesja apo subjekti i këtij hetimi disiplinor.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me 6 prill 2023, pasi e shqyrtoj kërkesën për përjashtim të gjyqtarit Faton Ademi, si Kryesues të panelit hetimor në lëndën disiplinore Nr.AD/KGJK/04/2023/GJTHPR-AD/GJTHPR.nr.02/2023, vlerësoj se e njëjta kërkesë për përjashtim është e bazuar në nenin 13 të Rregullores 05/2019 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve dhe njëzëri të njëjtën kërkesë e miratoj si të bazuar.

Albert ZOGAJ,
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës